

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Janar, 2017


Tiranë, më 22 Shkurt 2017: Ndryshimi vjetor i Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në muajin Janar 2017 është 4,0 %. Ky ndryshim, është ndikuar kryesisht nga rritja vjetore e çmimeve të grupit “Ushqime dhe pije alkoolike” me 8,5 %, pasuar nga grupet “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,2 %, “Argëtim dhe kulturë” me 2,8 %, “Transport” me 2,7 % etj.

Në muajin Janar 2017 ndryshimi mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është 2,5 %. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të frutave dhe zrazavateve, gazit të lëngshëm për makina, etj.

Fig. 1 Krahasimi i ecurisë të IHÇK dhe IÇK-së




Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Tab. 1 Ndryshimet në përqindje matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet	Peshat	01-17 / Vit-2016	01-17/12-15	01-17/01-16	01-17/12-16
Gjithsej		1.000,0	3,4	5,0	4,0	2,5
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	380,2	7,8	11,3	8,5	6,4
02	Pije alkoolike dhe duhan	46,6	0,4	1,4	0,9	0,1
03	Veshje dhe këpucë	44,8	1,0	0,1	0,7	-0,8
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	75,6	1,1	2,7	0,9	0,4
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	69,5	0,1	0,3	-0,1	0,1
06	Shëndeti	75,8	0,1	0,3	0,3	0,1
07	Transporti	71,9	1,2	-0,7	2,7	0,1
08	Komunikimi	20,7	0,1	0,3	0,3	-0,3
09	Argëtim dhe kulturë	20,8	1,8	3,0	2,8	0,1
10	Shërbimi arsimor	41,6	0,5	0,7	0,7	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	99,2	0,0	0,1	0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	53,3	2,0	3,3	3,2	0,0

Fig.3 Ndryshimi vjetor i IHÇK



Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë të dizenuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguar për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, të përbashkëta dhe turistët në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

- Ngjashmeritë midis IÇK dhe IHÇK

- Qëllimi

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- Sistemi i klasifikimit

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP)

- Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve (HFMCE).

- Të dhënat e çmimeve

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njëjtat njësi tregtare, përdorin të njëjtin klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- Periudha referuese (bazë)t

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudhë bazë muajin Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100)

- Metodologjia

IÇK dhe IHÇK ndjekin të njëjtën metodologji në hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve që ndjek Rregullorja e Komisionit Evropian (KE) që janë zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së), në bashkëpunim me Institutet Statistike Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

- Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit

➤ IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri

➤ IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- Mbulimi i produkteve

➤ IÇK përmban 332 produkte

➤ IHÇK përmban 331 produkte (qiraja e imputuar nuk është element i shportës)

- Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)
 - Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjare private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
 - IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private dhe institucionale, si dhe shpenzimet e vizitorëve rezidentë dhe jo-rezidentë.

- Peshat
 - Peshat e IÇK janë të shprehura për 100
 - Peshat e IHÇK janë të shprehura për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
Gjithsej		100,0	1.000,0
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	378,6
02	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	33,0
03	Veshje dhe këpucë	4,0	44,6
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	75,3
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	6,5	69,2
06	Shëndeti	3,0	62,2
07	Transporti	6,2	48,3
08	Komunikimi	2,5	20,6
09	Argëtim dhe kulturë	2,6	169,5
10	Shërbimi arsimor	2,5	29,9
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	30,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	38,4

Shpjegime metodologjike

Në muajin Janar 2017 INSTAT publikon për herë të parë Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit llogaritur bazuar në:

1. Regulloren e KE Nr 2494/95
2. Ligjin e Statistikës Nr 9180 dt.5.2.2004 për Statistikat Zyrtare, i ndryshuar
3. Programin e Statistikave Zyrtare 2012-2016.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT:

Periodha rreferuese e çmimeve është muaji Dhjetor 2016 ndërsa periodha rreferuese e indeksit është muaji Dhjetor 2015. (Dhjetor 2015=100)

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është llogaritur nga INSTAT edhe gjatë vitit 2016 duke patur si periudhë referuese indeksin e muajit Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015 =100)

Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me Regulloren e KE Nr.1114/2010 dhe rregulloren e KE Nr. 1688/98. Peshat reflektojnë strukturën e Shpenzimeve Monetare të Konsumit Final të familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë.

- PËRKUFIZIME

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe të huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmejt vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Unionin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.